



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.505/ 4 prot.

Datë 24 /02/2026

V E N D I M
Nr. 299 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24/02 /2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-75737-02-10-2026 me objekt: “Blerje veshje, paisje sigurie, materiale mbrojtëse për punime elektrike, për punime speciale dhe shërbime”, me fond limit 3,860,400.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 23-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Albanian Gas Service Company Sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “Assanet ” sh.p.k, *NIPT L41817014E, me adresë: Rruga “Nënë Tereza ”, Pallati ngjit me Renerin.*

Autoriteti Kontraktor: Albanian Gas Service Company Sh.a, me adresë: *Rruga “Kosovarëve”, pallati: NdërPro, Tiranë.*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i

Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11-02-2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur- e thjeshtuar”, me nr. REF-75737-02-10-2026 me objekt: “Blerje veshje, paisje sigurie, materiale mbrojtëse për punime elektrike, për punime speciale dhe shërbime”, me fond limit 3,860,400.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 23-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Albanian Gas Service Company Sh.a.

II.2. Në datën 17.02.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “Assanet” SHPK, me nr. 505/2026 prot., datë 18.02.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6340, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimesit.

II.4 Me shkresën me nr. 19/6 prot., me datë 05.08.2025, protokolluar me tonën nr. 505/1prot., me datë 19.02.2025 autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, trajtimin e ankesës, ku ka vendosur refuzimin e saj.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Assanet” sh.p.k mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit me argumente si vijon: [*Kjo procedure prokurimi ka perfshire dy natyra te ndryshme: mallra dhe sherbime te cilat nuk lidhen me njera tjetren.*

Sipas shtojces nr 7 shikojme artikujt me nr rendor 38,39,dhe 40 jane sherbime dhe kalibrime dhe nuk jane te njejte me natyren e atyikujve te prokurimit dhe tipit te percaktuar ne njoftimin e kontrates : Mallra

38 *Mirëmbajtja dhe testimi i bombolave të ajrit MSA (Ne te gjitha qendrat e Mirembajtjes)*

39 *Rimbushja e bombolave të ajrit MSA 2 here ne vit*

(Ne te gjitha qendrat e Mirembajtjes)

40 *Testi i kalibrimit 2 here ne vit per cdo Gas detector në ambientet e AGSco*

(Ne te gjitha qendrat e Mirembajtjes)

Shtojca 7.

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Afati i lëvrimit: Nga data e nënshkrimit të marreveshjes kuader deri me 31.12.2026.

Nr.	Pershkrimi i mallrave	Njesia	Sasia		
1	Detektor tek i gazit te ndezshëm LEL CH4	cope	3		
2	Helmetë sigurie cope	13			
3	Mbrojtëse dëgjimi shume pozicionesh	Cope	3		
4	Tapaveshësh të lidhura me fije	kuti	1		
5	Syzet e sigurisë te polarizuara PS18	cope	81		

6	Xham i tejdukshëm zëvendësues për strukturën e montuar në helmetë	cope	3
7	Strukturë e montuar në helmetë për të vendosur xhamin e tejdukshëm	cope	3
8	Kominoshe rezistente ndaj zjarrit për sezonin e verës (preferohet ngjyre blu)	cope	
23			
9	Kominoshe per kimikatecope	65	
10	Xhaketë rezistente ndaj zjarrit Antistatike (preferohet ngjyre blu)	cope	38
11	FR401 Pantallona verore rezistente ndaj zjarrit antistatike (preferohet ngjyre blu)	cope	
38			
12	FR81 Triko Kapuç Antistatike (preferohet ngjyre blu)	cope	37
13	FR33 Bluzë Antistatike (preferohet ngjyre blu)	cope	38
14	Jelek Hi-Vis Flakë-Durues Anti-Statik	cope	2
15	Xhaketë rezistente ndaj zjarrit e papërshkueshëm nga uji	cope	1
16	Mushama shiu me dukshmëri të lartë	cope	28
17	Kapuç antistatik dimëror rezistent ndaj zjarrit Balaclava	cope	28
18	Këpucë sigurie S3 SRC ESD 94405-00	cope	10
19	Këpucë sigurie S3 ËR SRC	cope	28
20	Cizme Sigurie S5 CI FO SRC	cope	5
21	Doreza mbrojtëse kundër të ftohtit	cope	39
22	Doreza të përgjithshme për punë, rezistente ndaj prerjes dhe me mbrojtje kundër ndikimit (anti-impact).	cope	17
23	Stol plastik izolues, për përdorim të brendshëm, i përshtatshëm për 24 kV.	cope	2
24	Doreza antistatike kimike	cope	11
25	Doreza rezistente ndaj prerjeve dhe te rehatshme	cope	195
26	Litar gjysmë Statik	cope	2
27	Elektrikgome dore ATEX	cope	3
28	Mbrojtëse për këmbët për gjarprinjtë	cope	6
29	Lëng kundër insekteve (Lotion insect repellent)	cope	38
30	Cantë Shpine Triple Pocket	cope	4
31	Çantë mbajtëse kepucesh ose helmete	cope	15
32	Rrjet koke për mushkonjat	cope	17
33	Krem për mbrojtje nga dielli SPF 50	cope	44
34	Kuti për ndihmën e parë në vendin e punës për 25 persona	cope	3
35	Kuti për ndihmën e parë për automjetet deri në 2 persona	cope	20
36	Set vegla pune 85 copë	cope	12
37	Mbrojtëse gjuri	cope	6
38	Mirëmbajtja dhe testimi i bombolave të ajrit MSA (Ne te gjitha qendrat e Mirembajtjes)		
cope	8		
39	Rimbushja e bombolave të ajrit MSA 2 here ne vit (Ne te gjitha qendrat e Mirembajtjes)	cope	8
40	Testi i kalibrimit 2 here ne vit per cdo Gas detector në ambientet e AGSco (Ne te gjitha qendrat e Mirembajtjes)	cope	38

Sipas nenit 4 Perkufizime te ligjit nr 162/2020, pika 19 dhe 20 :

19 “Kontrata publike për punë” janë kontratat publike që kanë si objekt të tyre: a) kryerjen ose projektimin dhe kryerjen e punëve në lidhje me një ose më tepër aktivitete ndërtimore, sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik; b) realizimin ose projektimin dhe realizimin e një pune; c) realizimin me anë të çdo mjeti të një pune, që përkon me kërkesat e specifikuara nga autoriteti kontraktor që ushtron një ndikim vendimtar në llojin ose projektin e punës.

20. “Kontratat publike për shërbime” janë kontratat publike, që kanë objekt kryerjen e shërbimeve, të tjera nga ato që përfshihen në pikën 19 të këtij neni.

25. “Mall” është çdo gjë materiale me vlerë ekonomike

Ligji I Prokurimit public ndan ne tre tipe kontrate : pune , mallra ose shërbime.

Nenet 39/40/41 te VKM nr 285 parashikojne kriteret sipas tipeve te kontrates:

SEKSIONI III 33

KËRKESA TË VEÇANTA SIPAS TIPEVE TË KONTRATAVE

Neni 39 Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike

Neni 40 Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave

Neni 41 Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve

Sipas nenit 42 te VKM-se :

Neni 42 Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote

Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur.

Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

Sipas nenit 42 kontrata pune/mall apo shërbim mund të ndahet në lote.

Ky ligj parashikon që brenda të njëjtit tip kontrate pune ose shërbime ose mallra mund të ndahen në lote sipas natyrës dhe objekteve.

Ndërsa kjo procedurë prokurimi ka përfshirë brenda një procedurë të vetme dy tipe të ndryshme,

Kompania jone nepermjet kesaj ankese kerkon qe kjo kontrate te ndahet ne lote sepse kemi te bejme me tipe te ndryshme kontrate mallra dhe shërbime .], Komisioni vëren se,

III.1.1. Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 7 “ Kriteret e veçanta të kualifikimit”, ka parashikuar si në vijim,

Shtojca 7.

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Afati i lëvrimit: Nga data e nënshkrimit të marreveshjes kuader deri me 31.12.2026.

Nr.	Pershkrimi i mallrave	Njesia	Sasia
1	Detektor tek i gazit te ndezshëm LEL CH4	cope	3
2	Helmetë sigurie	cope	13
3	Mbrojtëse dëgjimi shume pozicionesh	Cope	3
4	Tapa veshësh të lidhura me fije	kuti	1
5	Syzet e sigurisë te polarizuara PS18	cope	81
6	Xham i tejdukshëm zëvendësues për strukturën e montuar në helmetë	cope	3
7	Strukturë e montuar në helmetë për të vendosur xhamin e tejdukshëm	cope	3
8	Kominoshe rezistente ndaj zjarrit për sezonin e verës (preferohet ngjyre blu)	cope	23
9	Kominoshe per kimikate	cope	65
10	Xhaketë rezistente ndaj zjarrit Antistatike (preferohet ngjyre blu)	cope	38
11	FR401 Pantallona verore rezistente ndaj zjarrit antistatike (preferohet ngjyre blu)	cope	38
12	FR81 Triko Kapuç Antistatike (preferohet ngjyre blu)	cope	37
13	FR33 Bluzë Antistatike (preferohet ngjyre blu)	cope	38
14	Jelek Hi-Vis Flakë-Durues Anti-Statik	cope	2
15	Xhaketë rezistente ndaj zjarrit e papërshkueshëm nga uji	cope	1
16	Mushama shiu me dukshmëri të lartë	cope	28
17	Kapuç antistatik dimëror rezistent ndaj zjarrit Balaclava	cope	28
18	Këpucë sigurie S3 SRC ESD 94405-00	cope	10
19	Këpucë sigurie S3 ËR SRC	cope	28
20	Cizme Sigurie S5 CI FO SRC	cope	5
21	Doreza mbrojtëse kundër të ftohtit	cope	39

22	Doreza të përgjithshme për punë, rezistente ndaj prerjes dhe me mbrojtje kundër ndikimit (anti-impact).	cope	17
23	Stol plastik izolues, për përdorim të brendshëm, i përshtatshëm për 24 kV.	cope	2
24	Doreza antistatike kimike	cope	11
25	Doreza rezistente ndaj prerjeve dhe te rehatshme	cope	195
26	Litar gjysmë Statik	cope	2
27	Elektrik gome dore ATEX	cope	3
28	Mbrojtëse për këmbët për gjarprinjtë	cope	6
29	Lëng kundër insekteve (Lotion insect repellent)	cope	38
30	Cantë Shpine Triple Pocket	cope	4
31	Çantë mbajtëse kepucesh ose helmete	cope	15
32	Rrjet koke për mushkonjat	cope	17
33	Krem për mbrojtje nga dielli SPF 50	cope	44
34	Kuti për ndihmën e parë në vendin e punës për 25 persona	cope	3
35	Kuti për ndihmën e parë për automjetet deri në 2 persona	cope	20
36	Set vegla pune 85 copë	cope	12
37	Mbrojtëse gjuri	cope	6
38	Mirëmbajtja dhe testimi i bombolave të ajrit MSA (Ne te gjitha qendrat e Mirembajtjes)	cope	8
39	Rimbushja e bombolave të ajrit MSA 2 here ne vit (Ne te gjitha qendrat e Mirembajtjes)	cope	8
40	Testi i kalibrimit 2 here ne vit per cdo Gas detector në ambientet e AGSco (Ne te gjitha qendrat e Mirembajtjes)	cope	38

III.1.2. Referuar Nenit 2 “Qëllimi i ligjit” i Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikon se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.3. Neni 3 “Parime të përgjithshme”, Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikon se: 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.4. Neni 39 i ligjit “162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikon se: Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale. 2. Autoriteti ose enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa ose për të gjitha lotet. Edhe kur ofertat mund të dorëzohen për disa ose të gjitha lotet, autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, nëse numri maksimal i loteve për ofertues deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar. Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve sesa numri maksimal, autoriteti ose enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen. 1. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti ose enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, pasi të kenë specifikuar në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.

III.1.5. Në nenin 42, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve. 2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektorial.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, KPP konstaton, se objekti i këtij prokurimi është “Blerje veshje, pajisje sigurie, materiale mbrojtëse për punime elektrike, për punime speciale dhe shërbime”. KPP vëren, se mallrat objekt - prokurimi veshje, pajisje sigurie, materiale mbrojtëse për punime elektrike dhe shërbime”. Duke vijuar me arsyen e pretendimit të operatorit ekonomik ankimues mbi modifikimin e kriterit ku kërkon *Sipas shtojces nr 7 shikojme*

artikujt me nr rendor 38,39,dhe 40 jane sherbime dhe kalibrime dhe nuk jane te njejte me natyren e atyikujve te prokurimit dhe tipit te percaktuar ne njoftimin e kontrates : Mallra

41 *Mirëmbajtja dhe testimi i bombolave të ajrit MSA (Ne te gjitha qendrat e Mirembajtjes)*

42 *Rimbushja e bombolave të ajrit MSA 2 here ne vit*

(Ne te gjitha qendrat e Mirembajtjes)

43 *Testi i kalibrimit 2 here ne vit per cdo Gas detector në ambientet e AGSco*

(Ne te gjitha qendrat e Mirembajtjes)

... Sipas nenit 42 kontrata pune/mall apo sherbim mund te ndahet ne lote.Ky ligj parashikon qe brenda te njejtit tip kontrate pune ose sherbime ose mallra mund te ndahen ne lote sipas natyres dhe objekteve.

*Ndersa kjo procedure prokurimi ka perfshire brenda nje procedure te vetme dy tipe te ndryshme, Kompania jone nepermjet kesaj ankese kerkon qe kjo kontrate te ndahet ne lote sepse kemi te bejme me tipe te ndryshme kontrate mallra dhe sherbime... Referuar pretendimit të operatorit ekonomik si dhe Grafikut të sasisë dhe lëvrimit shtojca 7 e DT, rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar ndër të tjera dhe shërbimet përkatësisht: - 38 Mirëmbajtja dhe testimi i bombolave të ajrit MSA (Ne te gjitha qendrat e Mirembajtjes); - 39 Rimbushja e bombolave të ajrit MSA 2 here ne vit (Ne te gjitha qendrat e Mirembajtjes); - 40 Testi i kalibrimit 2 here ne vit per cdo Gas detector në ambientet e AGSco (Ne te gjitha qendrat e Mirembajtjes)., është e evidentueshme qartë që përvecse një artikujve të përcaktuar nga nr. 1 deri në 37 të shtojcës 7 autoriteti ka kërkuar dhe shërbimet e cituara përkatësisht në nr. 38; 39 dhe 40 pjesë e shtojcës 7, nga ku rezulton se ka të përfshirë brenda saj edhe elementë të natyrës së shërbimit konkretish: *mirëmbajtja dhe testimi i bombolave të ajrit MSA (Ne te gjitha qendrat e Mirembajtjes; Rimbushja e bombolave të ajrit MSA 2 here ne vit (Ne te gjitha qendrat e Mirembajtjes)DHE Testi i kalibrimit 2 here ne vit per cdo Gas detector në ambientet e AGSco(Ne te gjitha qendrat e Mirembajtjes).*Referuar parashkrimeve në ankesë rezulton, se ankimuesi kërkon ndarjen në lote të procedurës së prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se ndarja ose jo, e një kontrate në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të prokurimit, pasi ndikon drejtpërdrejtë në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, kostot e ekzekutimit të kontratës dhe vështirësia teknike lidhur me ndarjen në lote etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të paktë. KPP vlerëson, se mosndarja në lote e procedurës së prokurimit në rastin konkret, ul konkurrencën në radhët e operatorëve ekonomikë dhe nuk stimulon pjesëmarrjen e biznesit të vogël. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për ndarjen e procedurës në lote, në respekt të parimit të barazisë, të nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, si dhe nxitjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.*

Përsa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e

rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Assanet” sh.p.k për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-75737-02-10-2026 me objekt: “Blerje veshje, paisje sigurie, materiale mbrojtëse për punime elektrike, për punime speciale dhe shërbime”, me fond limit 3,860,400.00 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 23-02-2026, nga autoriteti kontraktor, Albanian Gas Service Company Sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Assanet” sh.p.k.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro